Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS
STOMATOLOŠKA KOMORA KOSOVA
DENTAL CHAMBER OF KOSOVA
Nr.Br.No. 2285 Dt. 25.03 2022

# Oda e Stomatologëve të Kosovës

**Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues me nr.2133 të datës 30.12.2021, Këshilli i Ekspertëve Profesional në përbërje të Prof. Asoc. Dr. Ferit Koçani, Prof. Dr. Agim Begzati, Prof. Ass. Dr. Ali Gashi, Prof. Ass. Dr. Ngadhnjim Domi, Prof. Ass. Dr. Jeta Kelmendi, Dr. sc. Kastriot Meqa, Dr. Merita Brovina dhe Dr. Nora Berisha, japin këtë:

## OPINION/UDHËZUES PROFESIONAL

## MBI ARRITJEN E KOMPETENCËS TË DOKTORIT TË STOMATOLOGJISË PËR DHËNIEN E SHËRBIMEVE SPECIFIKE STOMATOLOGJIKE NGA IMPLANTOLOGJIA DHE ORTODONCIA NË SEKTORIN PRIVAT

Procesi i arritshmërisë së kompetencës së doktorit të stomatologjisë për shërbimet specifike stomatologjike nga implantologjia dhe ortodoncia realizohet përmes trajnimeve shtesë (bazike dhe të avansuar) të domosdoshme dhe me optimum të përvojës aktive profesionale, të propozuara si më poshtë:

## I. IMPLANTOLOGJIA

### A. KRITERET BAZË

1. Për specialistët e kirurgjisë orale, maksillofaciale dhe parodontologjisë të cilët në plan-program kanë të integruar implantologjinë në edukimin e vazhdueshëm profesional specialistik, ose këtë e kanë arritur në trajnime shtesë (të dëshmuara me kurset në implantologji), e kanë të drejtën e ushtrimit të kompetencës.

2. Specializantët në kirurgji orale, maksillofaciale dhe parodontologji, pasi të kenë përfunduar vitin e parë të stazhit specialistik, dhe kanë kryer trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike dhe të avansuara), mund ta ushtrojnë këtë kompetencë.

3. Specialistët e lëmive jo kirurgjike mund të fillojnë ushtrimin e kompetencës së implantologjisë pasi të kenë marrë trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike dhe të avansuara).

4. Për stomatologët e diplomuar, të licencuar, kërkohet të ketë së paku 2 (dy) vite përvojë aktive në institucion publik ose privat dhe që kanë kryer trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike dhe të avansuara).

5. Doktori i stomatologjisë i cili e ka kryer kurset bazike dhe të avansuara nga implantologjia dhe është duke e ushtruar këtë kompetencë para miratimit të këtij opinioni të miratuar nga Kuvendi i Odës, ata mund të vazhdojnë ta ushtrojnë këtë kompetencë, por duhet të kenë dëshmitë relevante mbi trajnimet nga implantologjia (certifkata dhe programi i kursit bazik dhe të avansuar i mbajtur nga eksperti i certifikuar).

## B. AKREDITIMI I AKTIVITETIT TË KURSIT

Trajnimet nga implantologjia (kursi bazik dhe i avansuar) të cilat njihen nga OSK, janë:

1. Kurset dhe trajnimet që organizohen nga OSK dhe subjektet tjera të autorizuara në përputhje me rregulloren e edukimit të vazhdueshëm profesional dhe aneks dokumenti 1 e këtijë opinioni profesional (Përmbajtja e kursit bazik dhe të avansuar nga implantologjia).

2. Kurset dhe trajnimet nga fusha e implantologjisë të mbajtura jashtë vendit të cilat janë në përputhje me Aneks dokumenti 1 (Përmbajtja e kursit bazik dhe të avansuar nga implantologjia) dhe të cilat kanë akreditim nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP).

3. Pjesa praktike realizohet nën mbikqyrjen e specialistit të kirurgjisë orale/maksillofaciale me përvojë pune 5 vjeçare në fushën e implantologjisë, në institucionin që ushtron veprimtarinë e implantologjisë, nën monitorimin e të cilëve bëhet ndërhyrja kirurgjike duke u bazuar në indikacionet, kundërindikacionet dhe planin e terapisë për vendosjen e implanteve; 2 implante në nofullën e epërme (interkanin dhe postkanin) dhe 2 implante në nofullën e poshtme (interkanin dhe postkanin).

4. Në rastet tjera për ndërhyrjet kirurgjike të veçanta, në varshmëri nga pozita dhe relacionet anatomike me strukturat e afërta anatomike, kërkohet patjetër ekspertiza specialistike dhe kurset shtesë të avansuara për ndërhyrjet e veçanta.

5. Kurset nga implantologjia që organizohen dhe akreditohen në nivel vendi, monitorohen nga specialistët e kirurgjise orale dhe maksillofaciale i përcaktuar nga KEVP.

## C. ANEKS DOKUMENTI 1

## PËRMBAJTJA E KURSIT BAZIK DHE TË AVANSUAR NGA IMPLANTOLOGJIA

Kursi në implantologji është proces i integruar i; leksioneve teorike, demonstrimit praktik në modele/mullaga dhe vendosjes drejtpërdrejtë në pacient.

Përmbledhje e shkurtër e moduleve.

### MODULI 1:

### HYRJE NË IMPLANTOLOGJI

a. Historia e osteointegrimit

- çka është osteointegrimi

- çka është e rëndësishme për të arritur osteointegrimin

b. Alternativat e trajtimit

- implantet si mënyrë për të trajtuar pacientët, përzgjedhja e trajtimit më të mirë, më të sigurt, më të parashikueshëm dhe më të përshtatshëm për pacientin.

c. Përzgjedhja e pacientit

- identifikimi i parametrave objektiv nëse një pacient është i përshtatshëm apo jo për të vendosur implante.

d. Indikacionet dhe kundërindikacionet për implant

- historia mjekësore, sëmundjet dhe gjendja e përgjithshme shëndetësore, si dhe ndikimi i saj në trajtimin e implantit

e. Pirja e duhanit, veset e këqija, statusi i dhembeve dhe patologjia që mund të kenë një ndikim negativ në implantet

f. Planifikimi i trajtimit, dokumentacioni

- Radiografitë e nevojshme

- Udhëzimet e ekzaminimit klinik

- Udhëzues kirurgjikal

- kompenzimi i përkohshem dhëmbëve pas vendosjes së implantit

**MODULI 2:**

**PLANIFIKIMI I TRAJTIMIT**

Ligjërata/leksione për përdorimin e Cone-Beam Computerized Tomography (CBCT)

- si funksionon CBCT për të optimizuar vendosjen e implanteve

**MODULI 3:**

**PLANIFIKIMI I TRAJTIMIT, DIZAJNI I IMPLANTIT DHE/OSE MENAXHIMI PRAKTIK**

a. leksione dhe teste vlerësuese për planifikimin e trajtimit

b. gjendja/vlerësimi klinik

c. teknika radiografike

d. literatura e bazuar në dëshmi

e. planifikimi i trajtimit të rasteve të vetë pjesëmarrësve

f. projektimi i implantit

g. dizajni makro dhe mikro i implantit

h. sipërfaqe të lëmuara dhe të vrazhda

i. implante të shkurtra/gjata/të ngushta ose të gjera

j. implante me një ose dy pjesë

k. lidhja e sheshtë në alveole kundrejt lidhjes konike

l. përzgjedhja e sistemit për implantim, dhe

m. kontrolli i cilësisë së procesit të planifikimit

**MODULI 4:**

**TEKNIKAT KIRURGJIKE**

a. leksione për teknikat kirurgjike

b. aspektet/pikëpamjet kirurgjike

c. rëndësia e njohjes së anatomisë

d. ekstraksioni atraumatik

e. kocka dhe shërimi i saj

f. dizajni i llambos/flap

g. teknikat e qepjes/suturimit

**MODULI 5:**

**TEKNIKAT KIRURGJIKE PËR IMPLANTIM - SIMULIMI NË MODELE**

a. përgatitja dhe pajisjet e nevojshme

b. përgatitja e modelit

c. trajnim praktik me modelet e implanteve

d. demonstrim kirurgjik

e. vendosja e implanteve

**MODULI 6 DHE 7:**

**VENDOSJA KIRURGJIKE E IMPLANTIT NË PACIENT - SIMULIMI NË MODELE**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë rastin/pacientin e planifikuar për vendosjen e implantit/implanteve; rishikojnë dokumentacionin, planin e trajtimit, formularët e pëlqimit, modelet, pasqyrën klinike dhe modelet e studimit.

**MODULI 8:**

**TRAJNIMI PROTETIKOR**

a. pacientë pa një dhëmb, padhëmbësi e pjesshme dhe padhëmbësi e plotë

b. ngarkimi i menjëhershëm me një fazë, konceptet e ngarkimit të hershëm dhe të vonuar

c. teknikat e marjes së masave

d. teknikat e masave analoge-dixhitale

e. konstruksionet e mbajtura me vidë kundrejt konstruksioneve të mbajtura me cement.

f. rregullat e ngarkimit dhe biomekanika

g. teknika me protezë

h. komponentet restauruese

i. skanim dixhital intra oral

**MODULI 9:**

**VENDOSJA KIRURGJIKE E IMPLANTEVE DHE RESTAURIMET TE PACIENTI**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë për rastet/pacientët e planifikuar për vendosjen e implantit/implanteve.

Vendosja e implanteve bëhet nga kursisti nën monitorim të ekspertit.

Kursisti bënë edhe planifikim të trajtimit protetikor – me mungesë të pjesërishme ose të plotë të dhëmbëve.

**MODULI 10, 11, 12:**

**VENDOSJA KIRURGJIKE E IMPLANTEVE DHE RESTAURIMET-TE PACIENTI**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë për rastet/pacientët e planifikuar për vendosjen e implantit/implanteve.

Vendosja e implantit/implanteve bëhet nga kursisti nën monitorim të ekspertit.

Kursisti bënë edhe planifikimin e trajtimit protetikor – me mungesë të pjesërishme ose të plotë të dhëmbëve.

Ligjërata dhe komente

- **Pas secilit modul ndjekësit e kursit i nënshtrohen vlerësimit nga udhëheqësi i kursit.**

**MODULI 13:**

**KURSI I AVANSUAR**

Teknikat e avansuara për shërbimet e veçanta që janë të ndërlidhuara edhe me implantologji janë kompetencë e kirurgut oral dhe maksilloacial.

## II. ORTODONCIA

### A. KRITERET BAZË

1. Për specialistët e ortodoncisë të cilët në plan-program kanë të integruar terapinë ortodontike në edukimin e vazhdueshëm profesional specialistik, ose këtë e kanë arritur me trajnime shtesë (të dëshmuara), e kanë të drejtën e ushtrimit të kompetencës.

2. Specializantët në ortodonci, pasi të kenë përfunduar vitin e dytë të stazhit specialistik, dhe kanë kryer trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike dhe të avansuara), mund ta ushtrojnë këtë kompetencë nën mbikëqyerjen e ortodontit me përvojë së paku 5 vjeçare.

3. Specialistët e Pedodoncisë, të cilët në plan-program kanë të integruar ortodoncinë interceptive në edukimin e vazhdueshëm profesional specialistik, ose këtë e kanë arritur me trajnime shtesë (të dëshmuara), e kanë të drejtën e ushtrimit të kompetencës te shërbimeve ortodontike interceptive.

4. Për specialistët e lëmive tjera dhe për stomatologët e licencuar, kërkohet që së paku të kenë 2 (dy) vite përvojë aktive në institucion publik ose privat dhe të kenë kryer trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike) për të fituar të drejtën e ushtrimit të kompetencës te shërbimeve ortodontike interceptive, në konsultim me ortodontin.

5. Për specialistët e lëmive tjera, për doktorët e stomatologjisë me përvojë punë së paku 5 vite, kërkohen trajnime shtesë (të dëshmuara për kurset bazike dhe të avansuara) për të ushtruar këtë kompetencë, nën mbikëqyerjen e përhershme të ortodontit i cili ka përvojë së paku 5 vite si specialist, me të cilin ka marrëveshje kontraktuale për mbikëqyerje të përhershme në terapinë ortodontike. Në të kundërtën nuk mund ta ushtron këtë kompetencë.

## B. AKREDITIMI I AKTIVITETIT TË KURSIT

Trajnimet nga ortodoncia (kursi bazik dhe i avansuar) të cilat njihen nga OSK, janë:

1. Kurset dhe trajnimet që organizohen nga OSK dhe subjektet tjera të autorizuara në përputhje me rregulloren e edukimit të vazhdueshëm profesional dhe aneks dokumenti 1 e këtijë opinioni profesional (Përmbajtja e kursit bazik dhe të avansuar nga ortodoncia).

2. Kurset nga ortodoncia të mbajtura jashtë vendit të cilat janë në përputhje me Aneks dokumenti 2 (Përmbajtja e kursit bazik dhe të avansuar nga ortodoncia) dhe të cilat kanë akreditim nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KEVP).

3. Realizimi praktik behet nën mbikqyrjen e specialistit të ortodoncisë i cili duhet të ketë së paku 5 vite përvojë specialistike, i cili bënë: ekzaminimin e pacientit dhe diagnostikimin, aprovimin e planit te terapisë, monitorimin e realizimit te teknikës së përzgjedhur terapeutike, vizitat e ndërmjetme kontrolluese, vlerëson rezultatin përfundimtar terapeutik dhe vendosjen adekuate të reteinerëve. Optimumi i rasteve që duhet të monitorohen është në relacion me anomalitë ortodontike dhe teknikat e përzgjedhura terapeutike në rrafshin sagital, tranzverzal dhe vertikal si dhe anomalitë e dhëmbëve në veçanti dhe të harqeve.

4. Për rastet ortodontike komplekse sipas indeksit për nevojen e trajtimit ortodontik grada 3,4,5 dhe komponentës estetike grada 5-10 dhe ato me natyrë skeletore, menaxhimi dhe trajtimi i tyre është kompetencë e ortodontit dhe kirurgut maksilloafcial.

5. Kurset nga ortodoncia që organizohen dhe akreditohen në nivel vendi, monitorohen nga specialistët e ortodoncisë, përcaktuar nga KEVP.

## C. ANEKS DOKUMENTI 1

## PËRMBAJTJA E KURSIT BAZIK DHE TË AVANSUAR NGA ORTODONCIA

Kursi në Ortodonci fikse është proces i integruar i; leksioneve teorike, demonstrimit praktik në modele/mullaga dhe vendosjes së drejtpërdrejtë të terapisë në pacient, percjellja e pacientit deri në fund të trajtimit duke e përfshirë edhe fazën e retencionit.

Përmbledhje e shkurtër e moduleve.

### TRAJNIMI BAZIK

### MODULI 1:
### HYRJE NË ORTODONCI

a. Historia e Ortodoncisë dhe Terapisë Fikse

- çka është Ortodoncia dhe terapia fikse ?
- cilat lloje të terapisë i përfshinë Ortodoncia ?

b. Rritja dhe zhvillimi prenatal i sistemit orofacial dhe okluzionit

- zhvillimi i hapësirës së gojës dhe fytyrës,
- zhvillimi i dhëmbëve,
- zhvillimi i neurokraniumit,
- zhvillimi i viscerokraniumit, si dhe
- dinamika e rritjes së skeletit kraniofacial.

c. Rritja dhe zhvillimi postnatal i sistemit orofacial dhe okluzionit

- dinamika e rritjes trupore,
- mënyra e rritjes së eshtrave kraniofacial,
- rritja e kraniumit,
- rritja e maksillës,

- rritja e mandibullës,

- dinamika e rritjes së skeletit kraniofacial.

d. Rritja dhe zhvillimi i okluzionit normal

- Stadi i pare i zhvillimit të okluzionit,

- Stadi i dytë i zhvillimit të okluzionit,

- Stadi i tretë i zhvillimit të okluzionit,

- Stadi i katërt i zhvillimit të okluzionit,

- Stadi i pestë i zhvillimit të okluzionit.

**MODULI 2:**

**FUNKSIONET OROFACIALE**

a. Hyrje në funksionet orofaciale

- Çka janë dhe cila është rëndësia e funksioneve orofaciale?,

- Anatomia dhe fiziologjia e muskujve orofacial.

b. Funksionet e regjionit orofacial

- frymëmarrja,

- të ushqyerit,

- gjidhënia,

- përtypja,

- gëlltitja,

- të folurit.

c. Funksioni i nyjës temporomandibullare

- Çka është nyja temporomandibullare ?

- Cilat struktura i përfshin nyja temporomandibullare?

- pozita e pushimit fiziologjik,

- okluzioni qendror,

- okluzioni i detyruar,

- pozita retropulzive dhe propulsive maksimale.

## MODULI 3:

## FAKTORËT ETIOLOGJIK TË MALOKLUZIONEVE

a. Hyrje në etiologjinë e malokluzioneve

- Çka është etiologjia e malokluzioneve?
- Si klasifikohen faktorët etiologjik të malokluzioneve?

b. Faktorët e përgjithshëm

- trashëgimia
- sëmundjet
- ushqimi deficitar
- disfunksionet endokrine
- anomalitë kongjenitale

c. Faktorët lokal

- sëmundjet
- traumat
- shtypja e jashtme
- crregullimet e funksioneve
- veset e këqija
- hiperdoncioni dhe hipodoncioni
- mikrodoncioni dhe makrodoncioni
- pozicioni jonormal i folikulit te dhëmbit
- humbja e hershme e dhëmbëve
- perzistimi dhëmbeve të qumështit
- shërimi jo i drejtë ortodontik dhe stomatologjik

## MODULI 4:

## ANOMALITË ORTODONTIKE

a. Hyrje në anomalitë ortodontike

- Çka janë anomalitë ortodontike ?

- Si klasifikohen anomalitë ortodontike?

b. IONT indeksi

- çka është IONT indeksi?

- përdorimi i tij te pacientët ortodontik,

- klasifikimi i këtij indeksi.

c. Anomalitë e dhëmbëve në veçanti

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të pozitës së dhëmbëve,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të numrit të dhëmbëve,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të madhësisë së dhëmbëve,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të formës së dhëmbëve,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të zhvillimit të strukturave dentare.

d. Anomalitë e harqeve dentare

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e dendësive,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e rrallësive,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të madhësisë së harqeve,

- klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e anomalive të formës së harqeve.

e. Anomalitë e rrafsheve

- Anomalitë e rrafshit sagjital

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e malokluzioneve të klasës I

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e malokluzioneve të klasës II

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e malokluzioneve të klasës III

- Anomalitë e rrafshit tranzverzal

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e kafshimit të kryqëzuar

- Anomalitë e rrafshit vertikal

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e kafshimi të hapur

    - klasifikimi, përshkrimi dhe etiologjia e kafshimmi të thellë

## MODULI 5:

## METODAT E EKZAMINIMIT TË PACIENTIT

a. Hyrje në diagnostikën ortodontike

- diagnostikimi i pacientit,

- diagnoza alternative,

b. Anamneza e pacientit

- rrjedhja e shtatzanisë dhe lindja,

- mënyra e të ushqyerit,

- sëmundjet e përjetuara të fëmijërisë,

- dëmtimet e dhëmbëve dhe nofullave,

- intervenimet kirurgjikale,

- shprehitë e këqija,

- veçoritë trashëguese.

c. Gjendja e përgjithshme

- konstitucioni,

- lartësia dhe pesha,

- analiza e funksioneve,

d. Indekset kraniofaciale

- analiza e profilit të fytyrës,

- analiza e anfazit,

- vija estetike e buzëve,

- tipi i kokës së pacientit,

- tipi i fytyrës së pacientit.

e. Statusi lokal i hapësirës së gojës

- gjendja e buzëve, zhvillimi dhe tonusi i tyre

- frenulum labi,

- gingiva,

- frenulum linguae,

- gjuha,
- higjiena orale,
- statusi dentar.

f. Fotografimi i pacientëve

- rëndësia e fotografisë në Ortodonci,
- aparatura e nevojshme për realizimin e fotografimit adekuat,
- llojet e fotografive ortodontike dhe ruajtja e tyre.

## MODULI 6:

## METODAT E DIAGNOSTIKIMIT TË MALOKLUZIONEVE

a. Diagnostika gnatometrike

- marrja e masës të pacientit,
- modeli i punës dhe pregaditja e tij,
- mjetet e nevojshme për analizë,

b. Analizimi i modeleve të punës

- mesi i harqeve dentare,
- analiza sagjitale e harkut dentar,
- analiza transverzale e harkut dentar,
- analiza vertikale e harkut dentar.
- analiza e bazave apikale,
- analiza sipas Schwarz,
- analiza sipas Moyers,
- analiza për caktimin e hapësirës përmes rentgen incizimeve,
- analiza sipas Berendok,
- analiza sipas Nance,
- analiza sipas Lundstrom,
- analiza sipas Bolton.

c. Analiza e radiografive të nevojshme

- rëndësia e rentgenit në ortodonci
- llojet e radiografive të nevojshme në ortodonci,
- analiza e rentgenit retroalveolar dhe ortopantomografisë

d. Analiza cefalometrike

- hyrje në cefalometri
- elementet në analizën cefalometrike
- matjet në analizën e kombinuar të telerentgenit
- aplikimi klinik i matjeve në telerentgen
- përcaktimi i tipit facial
- përcaktimi i tipit të profilit të fytyrës dhe raporteve ndërnofullore ndaj bazës së kafkës
- përcaktimi i raporteve intermaksillare
- përcaktimi i gjatësisë së fytyrës
- përcaktimi i pozitës së incizivëve
- matje tjera në telerentgen sipas autorëve të ndryshëm

- **Pas secilit modul, ndjekësit e kursit i nënshtrohen vlerësimit nga udhëheqësi i kursit.**

## TRAJNIMI I AVANCUAR

### MODULI 1:

### HYRJE NË ORTODONCINË FIKSE

a. Përgaditja e pacientit para fillimit të terapisë fikse

- identifikimi i parametrave objektiv nëse një pacient është i përshtatshëm apo jo për të vendosur terapi ortodontike fikse.
- shqyrtimi i dokumenteve të fituara nga të gjitha analizat e realizuara.
- kohëzgjatja e trajtimit
- vizitat e rregullta

- terapia ortodontike fikse si mënyrë për të trajtuar pacientët, përzgjedhja e trajtimit më të mirë, më të sigurt, më të parashikueshëm dhe më të përshtatshëm për pacientin.

- planifikimi i bashkëpunimit me lëmitë tjera specialistike pas përfundimit të terapisë ortodontike fikse.

- motivimi i pacientit

- historia mjekësore, sëmundjet dhe gjendja e përgjithshme shëndetësore, si dhe ndikimi i saj gjate terapise ortodontike fikse.

**MODULI 2:**

**OKLUZIONI**

a. Përzgjedhja e pacientit

- çka paraqet okluzioni?

- cilat janë komponentat jodentale të sistemit orofacacial?

- cilat janë komponentat dentale të sistemit orofacial?

- cilat janë aspektet funksionale të okluzionit?

b. Qëllimet e trajtimit ortodontik

- përshkrimi i qëllimeve të trajtimit ortodontik

- fushat e veprimit të aparateve fikse

c. Bazat e biomekanikës

- çka paraqet biomekanika në ortodonci?

- cilat janë bazat biologjike?

- llojet e forcave ortodontike

- ndryshimet në struktura pas aplikimit të forcave

- fazat e lëvizjes së dhëmbit

- faktorët që ndikojnë në lëvizjen e dhëmbëve

- pasojat klinike të mekanizmave biologjik

- efektet e dëmshme të forcave

- mekanika e lëvizjes së dhëmbëve

- ankorimi

## MODULI 2:

## ELEMENTET E APARATEVE FIKSE

a. Elementet pasive të aparateve fikse

- çka paraqet elementet pasive të aparateve fikse?
- çka janë breketat, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë tubat bukal, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë unazat, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- cilat janë elementet tjera pasive, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?

b. Gjeneratorët e forcave në teknikën fikse

- çka janë harqet ortodontike të telit, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë elementet elastike, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?

c. Elementet përcjellëse të aparateve fikse

- çka janë paisjet ekstraorale, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë harqet transpallatinale, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë ekspanderët pallatinal, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë aparatet për qarje të qeiellzës, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?
- çka janë Jusper jumper dhe Jones jig, si klasifikohen dhe karakteristikat e tyre?

## MODULI 3:

## VENDOSJA E APARATIT ORTODONTIK FIKS

a. Elementet përcjellëse të aparateve fikse

- vendosja e breketave dhe tubave
- fiksimi i breketave
- vendosja e unazave
- vendosja e elementeve tjera
- efektet e dëmshme të shkaktuara nga prezenca e aparateve fikse
- shkaktarët e shkapjes së brekeave
- largimi i breketave dhe unazave

b. Stadet e trajtimit fiks

- stadi i parë i trajtimit,

-çka përfshinë?

-cilat anomali i përmirëson në këtë stad,

-cilat elemente pëdoren në këtë stad të trajtimit si dhe

-kur është i gatshëm pacienti të kaloj në stadin e ardhshëm.

- stadi i dytë i trajtimit,

-cka përfshinë?

-cilat anomali i përmirëson në këtë stad?

-cilat elemente pëdoren në këtë stad të trajtimit si dhe

-kur është i gatshëm pacienti të kaloj në stadin e ardhshëm.

- stadi i tretë i trajtimit,

-cka përfshinë?

-cilat anomali i përmirëson në këtë stad ?

-cilat elemente pëdoren në këtë stad të trajtimit si dhe

-kur është i gatshëm pacienti të kaloj në fazën e ardhshme?

**MODULI 4:**

**RETENSIONI**

a. Ruajtja e rezultateve të terapisë fikse

- çka kuptojmë me retencion?

- çka është recidivi?

- planifikimi i kohës dhe metodës së retencionit

- llojet e retinerëve

- vendosja dhe përcjellja e pacientit në këtë fazë

**MODULI 5:**

**TEKNIKA TE VEÇANTA NE ORTODONCINË FIKSE**

a. Teknika Edgewise

-çka përfshinë?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

b. teknika SWA

-çka përfshinë?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë ?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

c. teknika BEGG

-çka përfshinë ?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

d. teknika Riketts

-çka përfshinë?,

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

e. teknika Burstone

-çka përfshinë ?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dhe anomali mund të trajtohen me këtë teknikë ?

f. teknika Zharabak

-çka përfshinë?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

g. teknika linguale

-çka përfshinë?

-cilat anomali trajtohen me këtë teknikë ?

-cilat elemente pëdoren në këtë teknikë të trajtimit si dhe

-cilat stade të trajtimit dheanomali mund të trajtohen me këtë teknikë?

**MODULI 6:**

**TEKNIKAT PRAKTIKE PËR VENDOSJEN E TERAPISE FIKSE - SIMULIMI NË MODELE**

a. përgatitja dhe pajisjet e nevojshme

b. përgatitja e modelit

c. trajnim praktik me modelet e pregaditura dhe breketa

d. demonstrim praktik i vendosjes së breketave

e. vendosja e breketave në modele

**MODULI 7 DHE 8:**

**VENDOSJA E BREKETAVE NË PACIENT - SIMULIMI NË MODELE**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë rastin/pacientin e planifikuar për vendosjen e breketave; rishikojnë dokumentacionin, planin e trajtimit, formularët e pëlqimit, modelet, pasqyrën klinike dhe modelet e studimit.

**MODULI 9:**

**VENDOSJA E BREKETAVE TE PACIENTI**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë për rastet/pacientët e planifikuar për vendosjen e breketave.

Vendosja e breketave bëhet nga kursisti nën monitorim të ekspertit.

**MODULI 10, 11, 12:**

**VENDOSJA E BREKETAVE DHE PERCJELLJA E PACIENTEVE DERI NE FUND TE TERAPISE ORTODONTIKE - TE PACIENTI**

Kursistët prezantojnë dhe diskutojnë për rastet/pacientët e planifikuar për vendosjen e breketave.

Vendosja e breketave bëhet nga kursisti nën monitorim të ekspertit.

Kursisti bënë edhe përcjelljen e pacientëve nën terapi fikse deri në fund të terapisë, vendos retinerët dhe i përcjell pacientët edhe në fazën e retencionit.

Ligjërata dhe komente

- **Pas secilit modul, ndjekësit e kursit i nënshtrohen vlerësimit nga udhëheqësi i kursit.**

1. Prof.Aasoc.Dr. Ferit Koçani- kryesues
2. Prof.Dr. Agim Begzati- anëtar
3. Prof.Ass.Dr. Ali Gashi – anëtar
4. Prof.Ass.Dr. Ngadhnjim Domi – anëtar
5. Prof.Ass.Dr. Jeta Kelmendi – anëtar
6. Dr.Sc. Kastriot Meqa – anëtar
7. Dr. Merita Brovina – anëtar
8. Dr. Nora Berisha – anëtar

Prishtinë, 24.03.2022